

Masat për ekzekutimin e mbështetjes financiare për fëmijën

Agjencitë e mbështetjes financiare për fëmijën kanë mënyrat e tyre për t'i inkurajuar prindërit që të paguajnë detyrimet e mbështetjes financiare për fëmijën.



Kur gjykata urdhëron që mbështetja financiare për fëmijën të paguhet përmes Njesisë së Arkëtimit të Detyrimit të Mbështetjes, ekzekutimi kryhet nga Zyra e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën (Office of Child Support Services). Ekzekutimi i këtij urdhri përfundon pasi të ndërpritet dhe të jenë bërë të gjitha pagesat.

- **Masat administrative të ekzekutimit** lejojnë OCSS-në të mbledhë dhe t'u kërkojë prindërve të kryejnë pagesat e vonuara për mbështetjen financiare për fëmijën. Nuk nevojitet seancë dëgjimore në gjykatë. Këto masa mund të merren nga agjencia e mbështetjes financiare për fëmijën sipas ligjit federal dhe shtetëror. Prindërve u dërgohet me postë një njoftim në banesë që i informon rreth procedurave. Njoftimi përmban edhe udhëzime për të pranuar ose kundërshtuar masën e marrë.
- **Masat e ekzekutimit gjyqësor** kërkojnë seancë dëgjimore.

Mësoni se si t'i përgjigjeni ose të kundërshtoni një masë ekzekutimi duke shkuar te <https://childsupport.ny.gov/order/enforce> ose përdorni kodin QR →



Masat administrative të ekzekutimit

Shuma e shtuar

Prindërve që paguajnë mbështetje financiare për fëmijën nga paga e tyre mund t'u kërkohej të paguajnë 50% vlerë të shtuar nëse vonojnë pagesat për mbështetjen financiare për fëmijën. Shuma e mbajtur nga paga do të reduktohet në shumën e caktuar me urdhër gjykate pas shlyerjes së detyrimit.

Kompensimi me anë të rimbursimit të tatimit

Nëse prindi pret një rimbursim federal ose shtetëror të tatimit mbi të ardhurat, e gjithë shuma ose një pjesë e saj mund të përdoret për shlyer pagesat e prapambetura për mbështetjen financiare për fëmijën. Kjo ndodh në rast të rimbursimit të tatimit nga shteti i Nju-Jorkut, nëse ekziston një detyrim me vlerë të paktën \$50 për mbështetjen financiare për fëmijën. Rimbursimi i tatimit federal do të bëhet nëse ekziston një detyrim me vlerë të paktën \$500 (\$150 nëse fëmija merr ndihmë ekonomike).

Pengimi i fitimeve të lotarisë

Për prindërit që fitojnë \$50 ose më shumë në lotarinë e shtetit të Nju-Jorkut, fitimet do të përdoren për mbështetjen financiare për fëmijën e tyre, nëse kanë një detyrim me vlerë të paktën \$600.

Konfiskimi i pronës:

OCSS-ja mund të sekuestrojë llogaritë bankare dhe asete të tjera financiare për të paguar mbështetjen financiare për fëmijën. Fondet në llogari bankare mund të merren nëse ka detyrime të prapambetura të mbështetjes financiare prej të paktën dy muajsh dhe me vlerë të paktën \$300. Prindërve që paguajnë mbështetje financiare për fëmijën nga paga e tyre nuk do t'u merren fondet nga llogaria bankare, me përjashtim të rastit kur kanë më shumë se \$3,000 në llogari.

Pezullimi i lejes së drejtimit të automjetit

Leja e drejtimit të një prindi mund të pezullohet nëse kanë detyrime të pashlyera të mbështetjes financiare për fëmijën prej katër muajsh ose më shumë. Leja e drejtimit nuk do të pezullohet nëse paguajnë mbështetje financiare për fëmijën nga paga e tyre. Leja e drejtimit pezullohet edhe nëse prindërit marrin përfitime publike ose nëse kanë të ardhura të ulëta. Pezullimi i lejes së drejtimit mund të hiqet nëse prindi i shlyen të gjitha pagesat e prapambetura. Pezullimi mund të hiqet edhe nëse prindi jep informacion për punësimin dhe nënshkruan një marrëveshje për shlyerjen e pagesave. Në raste të caktuara, Departamenti i Mjeteve Motorike (Department of Motor Vehicles) i Shtetit të Nju-Jorkut mund ta heqë pezullimin për të lejuar udhëtimin me makinë për të shkuar dhe për t'u kthyer nga puna.

Denoncimi në Byronë e Kreditit

Llogaritë e prindërve që kanë detyrim të papaguar prej të paktën \$1,000 ose janë dy muaj mbrapa me pagesën e mbështetjes financiare për fëmijën do t'u dërgohen Agjencive të Raportimit të Konsumatorit (Consumer Reporting Agencies, CRA). Kjo do të lërë shenjë negative në profilin e kreditit të prindit dhe mund të ndikojë te marrja e kreditit (p.sh. hipoteka, kredi makine, karta krediti, etj.)

Referimi te Departamenti i Tatimeve dhe Financës (Division of Taxation And Finance) i Shtetit të Nju-Jorkut

Departamenti i Tatimeve dhe Financës i Shtetit të Nju-Jorkut (DTF) njoftohet kur prindi ka detyrime të pashlyera të mbështetjes financiare për fëmijën prej katër muajsh ose më shumë, me vlerë totale \$500 ose më shumë. Kjo mund të rezultojë në identifikimin dhe sekuestrimin e aseteve (p.sh. varka, shtëpi, makina) për të shlyer pagesat e prapambetura të mbështetjes financiare për fëmijën. Prindërit që marrin përfitime publike ose që kanë të ardhura të ulëta nuk referohen te DTF-ja. Prindërit që paguajnë mbështetje financiare për fëmijën nga paga e tyre, në kohën kur identifikohen për DTF, përjashtohen nga referimi në DTF. Prindërit që fillojnë të paguajnë mbështetje financiare për fëmijën nga paga e tyre, pasi janë zgjedhur për DTF nuk përjashtohen nga DTF-ja.

Refuzimi i marrjes ose rinovimit të pasaportave

Departamenti Amerikan i Shtetit (U.S. State Department) do ta refuzojë kërkesën për marrjen ose për rinovimin e pasaportës nëse detyrimi i mbështetjes financiare për fëmijën është të paktën \$2,500. Për të marrë pasaportë të re, prindërit duhet të shlyejnë pagesat e prapambetura të mbështetjes financiare për fëmijën. Prindi mund të jetë në gjendje të marrë një pasaportë të re në rrethana urgjente.

Refuzimi i marrjes ose rinovimit të licensave profesionale dhe të biznesit në qytetin e Nju-Jorkut

Prindërit mund të mos jenë në gjendje të marrin ose të rinovojnë një licensë aktuale të lëshuar nga agjencitë e Nju-Jorkut. Kjo ndodh kur prindi nuk ka shlyer pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën prej katër muajsh ose më shumë. Prindërit duhet të shlyejnë të gjitha detyrimet e mbështetjes financiare për fëmijën për të lidhur marrëveshje për shlyerjen e pagesave ose për të marrë licensë. Gjithashtu, ata mund të paraqesin një dokument që deklaron se u nevojitet licensa për t'u punësuar.

Proceset e ekzekutimit gjyqësor

Kërkesë për shkelje

Kërkesa për shkelje përdoret për t'i kërkuar Gjykatës së Çështjeve Familjare që të ekzekutojë urdhrin për mbështetjen financiare për fëmijën. Kjo ndodh kur prindi nuk e ka paguar mbështetjen financiare për fëmijën, të urdhëruar nga gjykata. Kërkesa për shkelje mund të dorëzohet nga prindërit kujdestarë ose nga OCSS-ja. Rezultatet e kërkesës për shkelje mund të përfshijnë:

- **Shuma parash të përcaktuara nga gjykata**
Gjykata vendos shumën që duhet të paguajë prindi. Shuma e prapambetur tarifohet me normë interesi 9% deri në shlyerjen e detyrimit.
- **Barra siguruese**
Gjykata mund të vendosë barrë siguruese mbi pronën e prindit. Detyrimet e pagesave të mbështetjes financiare për fëmijën duhet të paguhen plotësisht para se prona të mund të shitet ose të transferohet.
- **Depozita në para**
Prindërve që nuk paguajnë në mënyrë të rregullt mund t'u duhet të bëjnë një pagesë garancie për pagesat e ardhshme për mbështetjen financiare të fëmijës.
- **Referimi te shërbimet e punësimit**
Gjykata mund t'i kërkojë prindit të bëhet pjesë e një programi për shërbimet e punësimit. Kjo do ta ndihmojë prindin me arsimin, trajnimin profesional dhe punësimin.
- **Arrestimi/burgosja**
Gjykata mund të lëshojë një urdhër arresti nëse prindi nuk paraqitet në gjykatë për të marrë pjesë në seancën për shkelje. Urdhri mund të lëshohet edhe nëse ka vonesa të gjata në pagesën e mbështetjes financiare për fëmijën. Nëse prindi i shmang qëllimisht pagesat e mbështetjes financiare për fëmijën, mund të lëshohet urdhër për burgosje deri në gjashtë muaj.

Pezullimi i licensave profesionale, të biznesit dhe të punës të lëshuara nga shteti:

Gjykata mund t'i pezullojë licensat e lëshuara nga shteti nëse prindi ka detyrime të pashlyera të mbështetjes financiare për fëmijën për të paktën katër muaj. Disa nga agjencitë shtetërore që lëshojnë licensa janë Zyra e Administratës Gjyqësore të Nju-Jorkut (NYS Office of Court Administration), Departamenti i Ruajtjes së Mjedisit i Shtetit të Nju-Jorkut (NYS Department of Environmental Conservation), Departamenti i Arsimit i Shtetit të Nju-Jorkut (NYS Department of Education), Departamenti i Shtetit i Nju-Jorkut (NYS Department of State) dhe Autoriteti e Pijeve Alkoolike i Shtetit të Nju-Jorkut (NYS Liquor Authority).

Referimi për ndjekje penale

Mospagesa e qëllimshme e detyrimeve të prapambetura të mbështetjes financiare për fëmijën është shkelje federale. OCSS-ja mund të kërkojë ndjekje penale nga Prokuroria e Shteteve të Bashkuara (United States Attorney's Office) ose nga Prokuroria e Qarkut (District Attorney's Office) kur detyrimi arrin një shumë të caktuar. Ky veprim mund të ndërmerret nëse mekanizmat e tjerë të ekzekutimit nuk kanë qenë të suksesshëm. Prindi duhet të ketë shkelur me qëllim urdhrin e mbështetjes financiare për fëmijën.